

REPUBLIKA E KOSOVES			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar		01.07.2020	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	060/01	20480	

PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KESHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSBB)
IZVEŠTAJ O SASTANKU OPŠTINSKOG ODBORA ZA BEZBEDNOST ZAJEDNICE (OOBZ)

Komuna / Opština: <u>Drenas</u> Data / Datum: <u>25.06.2020</u>
Numri i takimit për këtë vit / Redni broj sastanka u ovoj godini: 4
<u>Takim i rregullt</u> / Redovni sastanak ☒ Takim i jashtëzakonshëm / Vanredni sastanak ☐
Numri i anëtarëve të KKSBB-së të pranishëm / Broj prisutnih članova OOBZ: <u>15</u>
A kanë marrë pjesë në takim përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, nëse janë anëtarë të KKSBB-së? Da li su predstavnici nevećinskih zajednica, u svojstvu članova OOBZ, prisustvovali sastanku? Po / Da ☐ Jo / Ne ☐ Nuk ka anëtarë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë/Nema članove koji predstavljaju nevećinske zajednice ☒
A kanë marrë pjesë anëtarë të tjerë përveç anëtarëve të KKSBB-së? Da li je neko osim članova OOBZ prisustvovao sastanku? Po / Da ☒ <i>KFOR-LMT K9.</i> Jo / Ne ☐ <i>Nëse "Po", ju lutem potenconi organizatën të cilën e përfaqësojnë</i> <i>Ukoliko je odgovor "Da", molimo navedite koje organizacije predstavljaju</i>
A është kryesuar takimi nga Kryetari i Komunës apo nënkryetari? Da li je sastankom predsedavao Gradonačelnik ili Zamenik? Po / Da ☒ Nënkryetari Jo / Ne ☐
Temat në rendin e ditës / Teme na dnevnom redu: Në mbledhje u diskutuan këto pika të rendit të ditës: 1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSBB-së të mbajtur me 20.05.2020; 2. Njoftim për masat e ndërmarra nga Drejtoria e Arsimit për testin e arritshmërisë; 3. Masat e ndërmarra nga Drejtoria e Inspeksionit për parandalim të përhapjes së pandemisë; 4. Të ndryshme. <i>Ju lutem, potenconi temat tjera për të cilat është diskutuar në të ndryshmet / Molimo navedite druge teme o kojima se diskutovalo:</i>

Konkluzionet / Zaključci:

Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur më 20.05.2020 u miratua unanimisht, pa vërejtje.

Me këtë rast nënkryetari Hasi i informoi të pranishmit me veprimet e ndërmarra nga Komuna që nga data 13 mars, kur u shpall situata e emergjencës shëndetësore në Kosovë, dhe për gjendjen aktuale me të infektuar. Nënkryetari Hasi tha se në sajë të përkushtimit të punës së Shtabit Emergjent Drenasi nuk u bë vatër e përhapjes së infeksionit, ndërsa 10 të infektuar të cilët janë aktualisht nga komuna jonë, janë raste kontakti si pasojë e punës në kolektive të mëdha.

Për pikën e dytë, drejtori i Drejtorisë për Arsim, Muhamet Gjoka, i njoftoi të pranishmit se testi i arritshmërisë dhe ai i maturës janë shtyrë për në fund të muajit gusht, por që situata mund të ndryshojë varësisht nga gjendja pandemike. Drejtoria Komunale e Arsimit ka marrë të gjitha masat e nevojshme për dezinfektimin eventual, për furnizim me maska dhe material të nevojshëm higjienik në mënyrë që të gjithë nxënësit të kenë mundësi të marrin pjesë në test.

Po ashtu, drejtori Gjoka, i njoftoi të pranishmit se drejtoria ka pranuar raporte ditore nga shkollat për ecurinë e mësimin on-line në përgjithësi, dhe për mbarëvajtjen e mësimin on-line për nxënësit e shkollave të mesme që rezultojnë të ketë qenë aktiviteti i suksesshëm për kushtet dhe rrethanat në të cilat është zhvilluar.

Për pikën e tretë, raportoi drejtori i Drejtorisë për Inspeksion, Milaim Hajdari, i cili tha se kjo drejtori ka inspektuar zbatimin e vendimeve të marra nga niveli qendror dhe ai lokal, dhe falënderoi të gjitha institucionet tjera për bashkëpunimin e ofruar, veçanërisht policinë e Drenasit. Drejtori Hajdari, në mënyrë të detajuar i njoftoi të pranishmit për veprimet e marra nga kjo drejtori si: mbyllje të lokaleve dhe institucioneve, kontrolle sanitare, procesverbale të lëshuara, aktvendime, gjopa mandatore, zbatim të urdhrave për ndalim qarkullimi dhe ankesa të konsumatorëve për ngritje çmimi apo ankesa tjera.

Ndër çështjet tjera të ngritura në takim ishin edhe ankesat e qytetarëve të fshatit Baicë, respektivisht lagjes Ramadani dhe Elshani, për ndotjen që vjen nga gurthyysi i cili gjendet në këtë fshat, si dhe për dëmet e shkaktuara në objektet e banimit si pasojë e minimeve nga ky biznes. Një çështje tjetër e cila u ngrit, ishte edhe operimi i transportit ilegal të kombave, një veprimtari e cila përveç të tjerash paraqet edhe shqetësim për sigurinë e udhëtarëve.

Procesverbali u përpilua nga koordinatori i KKSB-së:

Izveštaj pripremio Koordinator OOBZ: Arben Shala

(emri, mbiemri dhe nënshkrimi / ime, prezime i potpis)

Procesverbali aprovohet nga Kryetari:

Izveštaj odobrava Gradonačelnik: Ramiz Lladrovci

nënshkrimi / potpis

Data e aprovimit / Datum odobravanja: 26.05.2020

Rekomandimet:

- Dërgimi i këtij procesverbali është obligim që del nga UA 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL neni 11 pika 6;
- Procesverbali përpilohet nga koordinatori i KKSB-së në Komunën përkatëse;
- Procesverbali duhet të dërgohet në MPB në e-mail adresën: mpb.dsb@rks-gov.net
- Procesverbali duhet të dërgohet në MAPL në e-mail adresën: Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net

Procesverbali duhet të dërgohet njëkohësisht me ftesën e takimit të ardhshëm të KKSB-së.